



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 5 , datë 22.12.1998

P Ë R

NDARJEN E TERRITORIT TË REPUBLIKËS NË BASENE  
UJËMBLEDHËSE DHE PËR KRIJIMIN E AGJENCIVE TË UJIT PËR  
KËTO BASENE

Në mbështetje të neneve 5,6 dhe 8, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Për administrimin e rezervave të ujit, territori i Republikës së Shqipërisë të ndahet në gjashtë basene ujëmbledhëse, sipas hartës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Basenet ujëmbledhëse janë ndarë si vijon:

- a. Baseni i Drin-Bunës
- b. Baseni i Matit
- c. Baseni i Ishëm-Erzenit
- ç. Baseni i Shkumbinit
- d. Baseni i Semanit
- e. Baseni i Vjosës

2. Për çdo basen të krijohet agjencia e ujit e basenit ujëmbledhës, ( më poshtë do të përdoret "agjencia e ujit"), e cila është institucion publik, administrativ, në varësi të Sekretariatit Teknik të KKU-së.

3. Qytetet ku do të vendosen selitë e agjencive të ujit janë:

- a. Për basenin e Drin-Bunës

Shkodra

- |                                |          |
|--------------------------------|----------|
| b. Për basenin e Matit         | Lezhë    |
| c. Për basenin e Ishëm-Erzenit | Tirana   |
| ç. Për basenin e Shkumbinit    | Elbasani |
| f. Për basenin e Semanit       | Fieri    |
| g. Për basenin e Vjosës        | Vlora    |

4. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Transportit dhe Turizmit e cila në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal, të sigurojë zyrat dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të agjencive të ujit.

5. Organika e çdo agjencie të jetë me tre punonjës, paga e të cilëve të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Rregullimit të Transportit dhe Turizmit.


6. Paga e punonjësve të agjencisë së ujit të jetë sipas lidhjes II-M, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.87, datë 30.1.1998.

7. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit të hartojë rregulloren e funksionimit të agjencive të ujit, si dhe aktet e tjera nënligjore, për plotësimin e strukturave të këshillave të baseneve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

PANDELI MAJKO



HARTA HIDROLOGJIKE E SHQIPERISE

DETI ADRIATIK



JUGOSLLAVIA

DETI ION

SHQIPERIA